



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0583

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj-Mexhuani-paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "WOOD CORPORATION" L.L.C., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizmi me perde për nevojat e Klinikave të Qkuk-së" me numër të prokurimit 701-23-5278-1-2-1, me 02/10/2023, mori:

Vendim

1. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e OE "WOOD CORPORATION" L.L.C. me (Nr. 2023/0583) e datës 14/08/2023, kurse vendimi i AK Qendra Klinike Universitare e Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizmi me perde për nevojat e Klinikave të Qkuk-së" me numër të prokurimit 701-23-5278-1-2-1 anulohet, ndërkaq Mbetet në fuqi, vendimi i AK i datës 26.07.2023 lidhur me aktivitetin prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij Vendimii datës .

2. Me qenë se ankesa e për OE "WOOD CORPORATION" L.L.C. – Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar, konfiskimi i depozitës dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me 24.05.2023, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka paraqitur Njoftimin për kontratë - B05, për aktivitetin e prokurimit "Furnizmi me perde për nevojat e Klinikave të Qkuk-së" me numër të prokurimit 701-23-5278-1-2-1 ndërsa me datë 27.07.2023 AK ka publikuar B58-Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka shpërblyer me kontratë N.P.P "Rolle Mont".

Me 01.08.2023 OE "WOOD CORPORATION" L.L.C., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek AK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Ndërsa me datë 03.08.2023 AK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizmi me perde për nevojat e Klinikave të Qkuk-së" me numër të prokurimit 701-23-5278-1-2-1, ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik ankues.

Operatori ekonomik ankues i pakënaqur me Vendimin e AK-së, me datë 14.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër protokolli 583/23.

Elementet qenësore të këtij aktiviteti të prokurimit konsistojnë si në vijim: Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës – furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 33,980.00 €.

Gjatë fazes së shqyrtimit paraprak,

Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrroj ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP. Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 15.08.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore.

Lidhur me ankesën nr.583/23, me datë 24.08.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar,
- Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër është pranuar nga gjitha palët. AK ka dhënë mendim rreth raportit - me anë të së cilit ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin dhe rekomandimit e ekspertit shqyrtues ndërsa Operatori ekonomik ankues ka pohuar se pajtohet me rekomandimin e ekspertit duke theksuar se “ *Sa i përket ofrimit të sqarimeve në lidhje me fotot e mostrave, kërkesën e ekspertit e kemi parë me vonesë, por meqë nuk ka pasur ndonjë udhëzim se ku të dërgohen mostrat, të njëjtat i kemi ngarkuar në sistem tek pjesa e dorëzimit të ankesës, andaj për panelin shqyrtues ato janë në dispozicion. Po ashtu diçka që mungon në raportin e ekspertit është konfirmimi i fabrikës prodhuese të lëndës së parë e cila konfirmon se perdet janë sipas dosjes së tenderit dhe të njëjtat janë anti bakteriale.*”

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Me datën 21.09.2023 është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor lidhur me këtë lëndë ku prezent ishin përfaqësuesit e palës ankuese dhe përfaqësuesit e Autoriteti Kontraktues.

Përfaqësuesi i OE Ankues gjatë seancës për shqyrtim kryesor ka sqaruar se mbetet në tërësi pranë ankesës duke pohuar si në vijim : Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 6, 7, 59 dhe 72 të LPP-së ngase nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit të ofertës sonë, ne kemi dorëzuar një listë të gjatë të kontratave me operator privat dhe publik të cilat i kemi realizuar si dhe një listë të

kontratave në realizim e sipër e ku vlera e këtyre kontratave për furnizim me inventar (duke përfshirë edhe perdet) janë disa miliona euro. Siç kemi cekur edhe në formularin e ankesës, shumë nga kontratat tona për furnizim me inventar përmbajnë edhe furnizim dhe montim të perdeve, mirëpo AK e ka injoruar këtë pjesë dhe nuk ka kërkuar as sqarime nga ne si operator siç obligohet me Nenin 72 të Ligjit. Ne edhe në formularin e ankesës kemi theksuar se si provë të ekzistimit të referencave Wood Corporation ofron një faturë të dorëzimit të inventarit për klientin Edilgraniti SHPK. Të tilla furnizime me perde ka në shumë kontrata të tjera si për shembull ajo me G-project, Komunën e Suharekes, Komunën e Prishtinës dhe shumë kontrata të tjera. Andaj nuk është fare kontestuese se ne e plotësojmë këtë kriter teknik. Sa i përket mostrave të dorëzuara, e sigurojmë OSHP-në se të njëjtat janë plotësisht në përputhje me dosjen e tenderit dhe në këtë pikë nuk do të ketë asnjë dilemë. Ne kemi fotografi dhe video të mostrave të dërguara në AK, nga ku vërehet se të gjitha kriteret janë të plotësuara. Në vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim thuhet po ashtu se kinse perdet nuk janë antibakteriale. Një gjë e tillë konstatohet lehtësisht me prova shkresore, ku vet prodhuesi i lëndës së parë perdeve na ka konfirmuar se produktet janë antibakteriale.

Eksperti shqyrtues nuk ka marr pjesë në seancë, mirëpo ka dorëzuar për OSHP një shkresë me përmbajtjen si në vijim :".Une i kam trajtuar dokumentet dhe pretendimet ankimore pasi nuk më janë ofruar disa sqarime që i kam kërkuar nga palët në procedurë e kam dorëzuar ekspertizën në atë formë. Pasi tani më janë ofruar nga AK dhe OE disa sqarime që unë i kam kërkuar po japë mendim lidhur me sqarimet shitesë sic keni kërkuar. Sa i përket kontratave dhe referencat arsyjeja pse kam menduar pjesërisht i bazuar është se kontrata dhe referencat janë furnizim me inventar, në inventar potencialisht mund të hyjnë edhe perdet pasi në ato kontrata dhe referenca përveç titullit nuk ka specifika tjera që tregojnë se çfarë inventari është furnizuar dhe meqë OE, ka bashkangjitur edhe disa foto nga puna e tyre me perde, kam rekomanduar që të kërkohen sqarime shitesë lidhur me këto kontrata dhe furnizime nëse ato kanë pasur edhe furnizim me perde-lëndë e aktivitetit në fjalë, duke ju referuar legjislacionit në fuqi për prokurim publik që lejon të merre informatat shitesë. Ndërsa, sa i përket mostrave të dërguara si foto nga AK dhe OE. Nga fotot e dërguara nuk shohë se ka Ngjyra RAL5010 (e kaltër e mbyllët) por meqë AK ka vendosur "Vërejtje: Për shkak të kërkesës specifike, ngjyra paraprakisht duhet të aprovohet nga njësia kërkuuese". Nga fotot duket se ka mostra perde nga te dy OE si ai i rekomanduar si OE ankues në formë rollne shih bashkangjitur dokumentin e dërguar nga AK dhe OE. Sipas AK "Mungon mekanizmi i perdeve shiritore është sjelle vetëm pjesa mbajtëse metalike, mungon mekanizmi në pjesën e sipërme dhe te poshtme te perdes shiritore". Nga fotot e dërguara nga OE janë disa mekanizma por konsideroj se duhet të vlerësohen nga ndonjë ekspert teknik, andaj e konsideroj ankesën si pjesërisht të bazuar".

Përfaqësuesit e AK gjatë seancës për shqyrtim kanë potencuar mes tjerash në plotësisht se qëndrojmë prapa vendimit të datës 26.07.2023, duke deklaruar më tej se OE ankues është eliminuar për dy arsye:1. KERKESA: Është kërkuar listë e kontratave të realizuara të natyrës së ngjashme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, të përcjellura me një referencë ose raport pranimit. EVIDENCA: Në kontratat dhe referencat e paraqitura në listë nuk figuron pozicioni furnizim apo montimi i perdeve.2. KERKESA: Është kërkuar Mostra të materialeve (perdeve dhe mekanizmit) Mostra të perdeve antibakteriale dhe profileve metalike-aluminit (mbajtësve dhe shiritit). Kurse Ankuesi ka prezantuar si në vijim:

- a) Perdet ndarëse nuk janë antibakteriale (dy materiale të ofruara) dhe nuk janë sipas specifikave të kërkuara në Pos 4 në paramasë.

- b) Perdet shiritore të ofruara nuk janë të duhura për natyrën e objekteve spitalore.
- c) Mungon mekanizmi i perdeve shiritore, është sjellë vetëm pjesa mbajtëse metalike, mungon mekanizmi në pjesën e sipërme dhe të poshtme të perdes shiritore.
- d) Perdja e tipit Rolle, është sjellë mekanizmi por mungon mostra e perdeve sipas Pos 2.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues pas administrimit provave dhe shkresave të kësaj lënde dhe pa ndonjë nevojë që në këtë rast të përshkruhen në detaje pretendimet reciproke të palëve dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, konsideron se: Ankuesi ka dorëzuar katalogun sipas së cilit mund të vërehet se lidhur me produktin e kërkuar (perde) sipas DT janë prezantuar po ashtu edhe specifikat (pa nevojë të përshkruhen) mirëpo vërejtjet parimore të AK nuk i referohen katalogut, por elementeve qenësore të produktit për ushtrimin e atyre funksioneve të cilat AK ka nevojë. Nga ana tjetër në DT janë paraparë në detaje elementet qenësore (specifikat) të produktit të kërkuar gjë që përshkrimi i këtyre specifikave duket të jetë fare i qartë për çdo furnitor, respektivisht operator ekonomik. Në seancën e shqyrtimit kryesor AK duke u bazuar në vlerësimin e bërë nga komisioni profesional i themeluar për këtë aktivitet, ka pohuar se perdet ndarëse nuk janë antibakteriale, nuk janë sipas specifikave të kërkuara, nuk janë të duhura për natyrën e objekteve spitalore, mungon mekanizmi sepse është sjellë vetëm pjesa mbajtëse metalike. Përderisa Ankuesi ka pohuar se ka kryer punë të ngjashme dhe nuk qëndrojnë pretendimet e AK duke theksuar se është dashur të veprohet sipas nenit 59 dhe 72 të LPP. Në të vërtetë, në pohimet e OE por edhe në raportin e ekspertit shqyrtues nuk gjenden prova jo kontestuese për të vërtetuar faktin se pohime ankimore kanë bazë. Kurse, Paneli konsideron se është jo kontestuese se AK publikisht (përmes publikimit të DT) është deklaruar se ka nevojë për produktin e cilësuar si perde, i cili në këtë rast ka një dedikim specifik, respektivisht për nevoja spitalore gjë që natyrisht se çdo lloj i produktit nuk i përmbush funksionet e kërkuara.

Në rrethana të tilla, Paneli konsideron se anulimi eventual i vendimit të AK dhe/ose rivlerësimi i aktivitetit të prokurimit nuk ofron ndonjë zgjidhje të drejtë për epilogun final të këtij aktiviteti dhe vendosi që vendimin e AK ta konsideroj të bazuar.

Paneli shqyrtues analizoi në kontekstin e përgjithshëm të këtij aktiviteti të gjitha pretendimet reciproke të palëve (Ankuesit dhe AK) dhe ato se çfarë përmban raporti i ekspertit, duke i analizuar me ndërgjegje dhe kujdes profesional dhe erdhi në përfundimin, sipas bindes së tij të pavarur se ankesa nuk mund të pranohet si e bazuar andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi sikurse në pikën 2, të dispozitivit është marrë në kuptim të nenit 31, paragrafi 5, i Rregullores së punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Prandaj duke ju referuar të lartcekurave dhe duke u bazuar në administrimin e gjithmbarshëm të provave, në dispozicion të shkresave të kësaj lënde, Paneli Shqyrtues bazuar në nenin 98, 99 lidhur me nenin 104 , 117 dhe 118 të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**
- **OE - WOOD CORPORATION L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: